



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

PROVIM I MATURËS SHTETËRORE 2026
ME ZGJEDHJE - SESIONI I

SKEMË VLERËSIMI

Kimi

Varianti A

23 qershor 2026

Shënim:

- Vlerësuesit e testeve janë trajnuar, që të vlerësojnë çdo përpjekje të nxënësit dhe të jenë të kujdesshëm, sidomos në pyetjet me zhvillim dhe arsyetim, që kanë më shumë se një mundësi zgjidhjeje.
- Çdo zgjidhje e dhënë nga nxënësit ndryshe nga skema e vlerësimit, por që komisioni i vlerësimit e gjykon si të saktë, do të marrë pikët përkatëse.
- Përgjigjet e sakta për pyetjet me alternativa vlerësohen me 1 pikë.

Përgjigjet e sakta për pyetjet me alternativa

Pyetja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Alternativa e saktë	B	D	D	D	A	B	A	B	C	C
Pyetja	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20
Alternativa e saktë	C	A	D	A	D	B	D	C	C	D

Përgjigjet e sakta për pyetjet me zhvillim

Pyetja 21 3 pikë

Përgjigje e plotë:

- a) Azoti (Grupi VA) është një gaz në formën e molekulave dyatomike N_2 , ndërsa neoni (Grupi VIIA) është gaz monoatomik, Ne. **1 pikë**
- b) Nga e majta në të djathtë në periode dobësohet karakteri metalik dhe forcohet ai jometalik i elementeve. Si rrjedhojë kalohet nga karakter bazik në atë amfoter e më pas acid, për oksidet dhe hidratet përkatëse. Litiumi është metal alkaline, si rrjedhojë, $LiOH$ (uj) shfaq karakter bazik të fortë. Në tretësirë ujore shpërbashkohet pothuajse plotësisht në jone: $LiOH_{(uj)} \rightarrow Li^+_{(uj)} + OH^-_{(uj)}$ **1 pikë**
- c) Oksidet që formojnë këto tre elemente janë: Li_2O ; BeO ; CO ; CO_2 . Numrat e oksidimit në këto okside për secilin element janë përkatësisht: Li (+1); Be (+2); C (+2 dhe +4).
Pra, Litiumi ka numrin më të vogël të oksidimit +1. **1 pikë**

- 3 pikë** Nëse nxënësi përcakton saktë gazin monoatomik (Ne) dhe elementin (Li) me numër oksidimit më të vogël në oksidin e tij, shkruan reaksionin e shpërbashkimit në jone të hidroksidit të litiumit si elektrolit i fortë.
- 2 pikë** Nëse nxënësi jep dy përgjigje të sakta.
- 1 pikë** Nëse nxënësi jep një përgjigje të saktë.
- 0 pikë** Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar **OSE** nuk ka shkruar fare në hapësirën e caktuar në dispozicion për zgjidhjen.

Pyetja 22 **3 pikë**

Përgjigje e plotë:



b) Masa e NaNO_3 të pastër: $\frac{80}{100} \cdot 140 \text{ g} = 112 \text{ g}$ **2 pikë**

$M_{\text{NaNO}_3} = 85 \text{ g/mol}$, $M_{\text{NaNO}_2} = 69 \text{ g/mol}$, $M_{\text{O}_2} = 32 \text{ g/mol}$

Bazuar në barazimin kimik të reaksionit, raporti $\text{NaNO}_3 : \text{NaNO}_2$ është 1 : 1

$$\frac{85 \text{ g}}{112 \text{ g}} = \frac{69 \text{ g}}{x \text{ g}} \Rightarrow x = 90.9 \text{ g NaNO}_2$$

Raporti $\text{NaNO}_3 : \text{O}_2$ është 2 : 1

$$\frac{2 \cdot 85 \text{ g}}{112 \text{ g}} = \frac{32 \text{ g}}{y \text{ g}} \Rightarrow y = 21 \text{ g O}_2$$

- 3 pikë** Nëse nxënësi shkruan saktë barazimin kimik të reaksionit të shpërbërjes, njehson masat në gram të produkteve.
- 2 pikë** Nëse nxënësi shkruan saktë barazimin kimik të reaksionit të shpërbërjes, njehson masën në gram të njërit prej produkteve.
- 1 pikë** Nëse nxënësi shkruan saktë vetëm barazimin kimik të reaksionit të shpërbërjes **OSE** njehson masën e NaNO_3 të pastër.
- 0 pikë** Nëse nxënësi e ka zgjidhur në mënyrë të gabuar **OSE** nuk ka shkruar fare në hapësirën e caktuar në dispozicion për zgjidhjen.

Pyetja 23 **4 pikë**

Përgjigje e plotë:

a) Molekulat e alkaneve janë jopolare dhe bashkëveprimi midis tyre realizohet me forcat Van der Vals (Forcat London). Alkanet me varg të degëzuar kanë më pak pika bashkëveprimi midis tyre se sa alkanet me varg normal. Pra, pikë vlimi më të ulët ka metil-2-butani. **2 pikë**

b) Një shembull reaksioni që zhvillohet sipas mekanizmit të zëvendësimit nukleofilik: **1 pikë**
 $\text{CH}_3 - \text{CH}_2 - \text{Br} + \text{OH}^- \rightarrow \text{CH}_3 - \text{CH}_2 - \text{OH} + \text{Br}^-$
 Pranohen dhe shembuj të tjerë.

c) Një aldehid kalon deri në acid karboksilik (grupi aldehidik shndërrohet në grup karboksilik). **1 pikë**
 $\text{CH}_3 - \text{CHO} \xrightarrow{[\text{O}]} \text{CH}_3 - \text{COOH}$
 Për të kryer këtë shndërrim mund të përdoren: KMnO_4 ; $\text{K}_2\text{Cr}_2\text{O}_7$; $\text{Ag}(\text{NH}_3)_2\text{OH}$ etj.

- a)** **2 pikë**
- 2 pikë** Nëse nxënësi argumenton saktë cila nga dy përbërjet ka pikë vlimi më të ulët.
- 1 pikë** Nëse nxënësi përcakton saktë përbërjen me pikë vlimi më të ulët pa e argumentuar.
- 0 pikë** Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar **OSE** nuk ka shkruar fare në hapësirën e caktuar në dispozicion për zgjidhjen.

- b) 1 pikë** Njëse nxënësi shkruan saktë një reaksion që zhvillohet sipas mekanizmit të zëvendësimit nukleofilik.
- 0 pikë** Njëse nxënësi shkruan gabim reaksionin **OSE** nuk ka shkruar fare në hapësirën e caktuar në dispozicion për zgjidhjen.
- c) 1 pikë** Njëse nxënësi shkruan saktë një reaksion ku tregohet se grupi aldehidik kalon në grup karboksilik.
- 0 pikë** Njëse nxënësi shkruan gabim reaksionin **OSE** nuk ka shkruar fare në hapësirën e caktuar në dispozicion për zgjidhjen.

Pyetja 24 2 pikë**Përgjigje e plotë:**

Mbështetur në Parimin Le Shatelje, shtimi i sasisë së NH_3 , e zhvendos ekuilibrin djathtas (në kahun që e kundërshton ndryshimin e bërë). Si rrjedhojë, sasia e joneve $[\text{Cu}(\text{NH}_3)_4(\text{H}_2\text{O})_2]^{2+}$ në tretësirë rritet dhe intensiteti i ngjyrës blu do të theksohet. **2 pikë**

- 2 pikë** Njëse nxënësi shpjegon saktë duke iu referuar Parimit Le Shatelje kahun e zhvendosjes së ekuilibrit dhe rritjen e intensitetit të ngjyrës.
- 1 pikë** Njëse nxënësi përcakton saktë kahun e zhvendosjes së ekuilibrit **OSE** jep kuptimin e Parimit Le Shatelje.
- 0 pikë** Njëse nxënësi e shpjegon në mënyrë të gabuar **OSE** nuk ka shkruar fare në hapësirën e caktuar në dispozicion për zgjidhjen.

Pyetja 25 4 pikë**Përgjigje e plotë:**

- a) Sipas teorisë së Brønsted-Lowry, acid është grimca që jep protone H^+ dhe bazë ajo që merr protone H^+ .

$$\text{CH}_3 - \text{COOH} + \text{H}_2\text{O} \leftrightarrow \text{CH}_3 - \text{COO}^- + \text{H}_3\text{O}^+$$

Acid
bazë e konjuguar

1 pikë
- b) $\text{CH}_3 - \text{COOH} + \text{KOH} \rightarrow \text{CH}_3 - \text{COOK} + \text{H}_2\text{O}$

Numri i moleve të acidit: $n = C_M \cdot V = 1 \text{ mol}$ Numri i moleve të bazës: $n = \frac{m}{M} = 0.5 \text{ mol}$

Raporti: $\text{CH}_3 - \text{COOH} : \text{KOH}$, është 1 : 1. Tepron 0.5 mol acid i dobët dhe formohen 0.5 mol kripë e këtij acidi, pra, formohet një tampon acid. $V_{\text{përzierjes}} = 1 \text{ litër}$ dhe $[\text{acidit}] = [\text{kripës}] = 0.5 \text{ mol/l}$

$$\text{pH} = -\log K_a - \log \frac{[\text{acid}]}{[\text{kripë}]} = 4.75 \quad \text{3 pikë}$$

- a) 1 pikë** Njëse nxënësi përcakton saktë bazën e konjuguar të acidit etanoik.
- 0 pikë** Njëse nxënësi e ka përcaktuar në mënyrë të gabuar **OSE** nuk ka shkruar fare në hapësirën e caktuar në dispozicion për zgjidhjen.
- b) 3 pikë** Njëse nxënësi përcakton saktë, me anë të njehsimeve vlerën e pH të tretësirës tamponë të përfutur.
- 2 pikë** Njëse nxënësi shkruan saktë barazimin kimik të reaksionit të asnjësimit dhe njehson numrin e moleve të secilit reaktant.
- 1 pikë** Njëse nxënësi shkruan saktë barazimin kimik të reaksionit të asnjësimit **OSE** njehson numrin e moleve të secilit reaktant.
- 0 pikë** Njëse nxënësi e ka zgjidhur në mënyrë të gabuar **OSE** nuk ka shkruar fare në hapësirën e caktuar në dispozicion për zgjidhjen.

Pyetja 26 **2 pikë****Përgjigje e plotë:**

a) Si faktor përshpejtues për këtë reaksion mund të jetë:

1 pikë

- rritja e temperaturës.
- katalizatori përshpejtues.
- rritja e përqendrimit të reaktantit.

Shembull: Përdorimi i katalizatorit përshpejtues ul E_a e reaksionit duke rritur numrin e grimcave me energji të mjaftueshme për të kaluar barrierën energjetike. Kjo ndikon në probabilitetin e rritjes së numrit të goditjeve efektive, pra në rritjen e shpejtësisë së reaksionit


b) Si faktor përshpejtues për këtë reaksion mund të jetë:

1 pikë

- rritja e temperaturës.
- katalizatori përshpejtues.
- rritja e përqendrimit të HCl.
- shkalla e grimcimit (sipërfaqja e kontaktit).

Shembull: Rritja e përqendrimit të tretësirës së HCl, rrit numrin e goditjeve duke rritur probabilitetin për një numër më të madh goditjesh efektive.

- a) **1 pikë**
1 pikë Nëse nxënësi shpjegon saktë me teorinë e goditjeve një nga faktorët që përshpejton reaksionin.
0 pikë Nëse nxënësi shpjegon në mënyrë të gabuar **OSE** nuk ka shkruar fare në hapësirën e caktuar në dispozicion për zgjidhjen.
- b) **1 pikë**
1 pikë Nëse nxënësi shpjegon saktë me teorinë e goditjeve një nga faktorët që përshpejton reaksionin.
0 pikë Nëse nxënësi shpjegon në mënyrë të gabuar **OSE** nuk ka shkruar fare në hapësirën e caktuar në dispozicion për zgjidhjen.

Pyetja 27 **2 pikë****Përgjigje e plotë:**

$$K_{\text{pt}} = [\text{Ag}^+]^2 \cdot [\text{S}^{2-}] \quad \text{Në tretësirën e ngopur } K_{\text{pt}} = P_j$$

$$[\text{Ag}^+] = 3,24 \cdot 10^{-17} \text{ M dhe } [\text{S}^{2-}] = 1,62 \cdot 10^{-17} \text{ M} \quad K_{\text{pt}} = 1,7 \cdot 10^{-50}$$

- 2 pikë** Nëse nxënësi shkruan saktë reaksionin e shpërbashkimit të kripës pak të tretshme dhe njehson saktë vlerën e K_{pt} .
- 1 pikë** Nëse nxënësi shkruan saktë reaksionin e shpërbashkimit të kripës pak të tretshme.
- 0 pikë** Nëse nxënësi e ka zgjidhur në mënyrë të gabuar **OSE** nuk ka shkruar fare në hapësirën e caktuar në dispozicion për zgjidhjen.

Pyetja 28 **5 pikë****Përgjigje e plotë:**

- a) Alkoolët, me strukturë të përgjithshme $R - \overline{O} - H$, janë molekula polare për shkak të polaritetit të lidhjeve $C - O$; $O - H$ dhe pranisë së çifteve elektronike vetjake të atomit qendror, oksigjenit, të grupit funksionar. Me rritjen e madhësisë së radikalit, zvogëlohet polariteti i molekulës, meqenëse radikali është apolar. **2 pikë**

b) Njehsohet numri i moleve të hidrokarburit dhe klorit.

2 pikë

$$n_{\text{hidrokarburit}} = \frac{V}{V_m} = 0.005 \text{ mol} \quad n_{\text{Cl}_2} = \frac{m}{M} = 0.01 \text{ mol molekula ose } 0.02 \text{ mol atome Cl}$$

$$n_{\text{atomeve H të zëvendësuar}} = 1 \cdot \frac{0.02}{0.005} = 4$$

c) Formula strukturore e hidrokarburit të kërkuar është: $\text{CH}_3 - \text{CH} = \text{CH} - \text{CH}_3$ (Buten-2)

1 pikë

- a) 2 pikë** Nëse nxënësi argumenton saktë polaritetin e molekulës së alkoolit dhe ndikimin e madhësisë së radikalit në polaritet.
- 1 pikë** Nëse nxënësi argumenton saktë polaritetin e molekulës së alkoolit **OSE** tregon ndikimin e madhësisë së radikalit në polaritet.
- 0 pikë** Nëse nxënësi argumenton në mënyrë të gabuar **OSE** nuk ka shkruar fare në hapësirën e caktuar në dispozicion për zgjidhjen.
- b) 2 pikë** Nëse nxënësi njehson saktë numrin e atomeve hidrogjen të zëvendësuar nga klori në molekulën e hidrokarburit.
- 1 pikë** Nëse nxënësi njehson saktë numrin e moleve të klorit, të hidrokarburit.
- 0 pikë** Nëse nxënësi e zgjidh në mënyrë të gabuar **OSE** nuk ka shkruar fare në hapësirën e caktuar në dispozicion për zgjidhjen.
- c) 1 pikë** Nëse nxënësi shkruan saktë formulën strukturore të hidrokarburit të kërkuar (buten-2).
- 0 pikë** Nëse nxënësi e zgjidh në mënyrë të gabuar **OSE** nuk ka shkruar fare në hapësirën e caktuar në dispozicion për zgjidhjen.

Pyetja 29 3 pikë

Përgjigje e plotë:

- a) Elementi i parë galvanik: Elementi i dytë galvanik: **2 pikë**
 Anodë: $\text{Fe} \rightarrow \text{Fe}^{2+} + 2 \text{e}^-$ (oksidim) Anodë: $\text{Mg} \rightarrow \text{Mg}^{2+} + 2 \text{e}^-$ (oksidim)
 Katodë: $\text{Cu}^{2+} + 2 \text{e}^- \rightarrow \text{Cu}$ (reduktim) Katodë: $2 \text{Ag}^+ + 2 \text{e}^- \rightarrow 2 \text{Ag}$ (reduktim)


b) Më shumë rrymë elektrike prodhon elementi galvanik që ka ndryshimin më të madh të aktivitetit (vetive reduktuese) midis metalit anodë dhe atij katodë. Bazuar në vlerat e potencialeve elektrodike standarde të reduktimit, kjo vërehet te elementi galvanik $\text{Mg} / \text{Mg}^{2+} // \text{Ag}^+ / \text{Ag}$.

1 pikë

- 3 pikë** Nëse nxënësi shkruan saktë gjysmëreaksionet redoks në elektrodën e të dy elementeve galvanike dhe shpjegon cili prej tyre prodhon më shumë rrymë elektrike.
- 2 pikë** Nëse nxënësi shkruan saktë gjysmëreaksionet redoks në elektrodën e secilit element galvanik **OSE** shkruan saktë gjysmëreaksionet redoks në elektrodën vetëm të njërit element galvanik dhe shpjegon cili prej tyre prodhon më shumë rrymë elektrike.
- 1 pikë** Nëse nxënësi shkruan saktë gjysmëreaksionet redoks në elektrodën vetëm të njërit element galvanik **OSE** shpjegon cili prej tyre prodhon më shumë rrymë elektrike.
- 0 pikë** Nëse nxënësi e ka zgjidhur në mënyrë të gabuar **OSE** nuk ka shkruar fare në hapësirën e caktuar në dispozicion për zgjidhjen.

Pyetja 30 **3 pikë****Përgjigje e plotë:**

- a) Molekula H_2O ka formë këndore me prejardhje nga tetraedri pasi atomi qendror, oksigjeni ($2s^2p^4$), ka dy çifte vetjake dhe formon dy çifte lidhëse. Dipolet e dy lidhjeve kimike nuk asnjansohen për rrjedhojë momenti dipolar i molekulës është i ndryshëm nga zero.



Molekula CO_2 ka formë lineare pasi atomi qendror, karboni, nuk ka çifte vetjake. Formon dy lidhje dyfishe, një me njërin oksigjen dhe një me tjetrin $O = C = O$. Dipolet e lidhjeve asnjansohen dhe momenti dipolar i molekulës është zero.

2 pikë

- b) Na ($3s^1$), është metal alkalin (metal shumë aktiv). Ka aftësi të lëshojë elektronin e nivelit të jashtëm elektronik duke u kthyer në kation Na^+ ndërsa klori Cl ($3s^2p^5$) është halogjen i grupit VIIA (jometal shumë aktiv). Ka aftësi të tërheqë një elektron duke u kthyer në anion Cl^- . Diferenca e EN midis tyre është e madhe, mbështetur kjo në vendin që zënë në Tabelën Periodike. Jonet tërhiqen me forca elektrostatike duke formuar kristalin NaCl. Tek HCl, janë dy jometale të cilët ndajnë elektrone të përbashkët, pra formojnë çift lidhës. Kjo lidhje është kovalente polare sepse formohet midis dy jometaleve me elektronegativitet të ndryshëm.

1 pikë

- a) **2 pikë**
Nëse nxënësi shpjegon (krahason) saktë karakteristikat e dhëna të dy molekulave.
- 1 pikë**
Nëse nxënësi shpjegon saktë karakteristikat e dhëna vetëm të njëjës prej molekulave.
- 0 pikë**
Nëse nxënësi jep shpjegim të gabuar **OSE** nuk ka shkruar fare në hapësirën e caktuar në dispozicion për zgjidhjen.
- b) **1 pikë**
Nëse nxënësi krahason saktë karakteristikën e dhënë midis dy përbërjeve.
- 0 pikë**
Nëse nxënësi jep shpjegim të gabuar **OSE** nuk ka shkruar fare në hapësirën e caktuar në dispozicion për zgjidhjen.

Pyetja 31 **3 pikë****Përgjigje e plotë:**

- a) Numri kuantik magnetik m, përcakton numrin e gjendjeve energjetike të një nëniveli si dhe orientimin e orbitaleve atomikë. **1 pikë**
- b) Formula elektronike e $_{30}Zn$: $[Ar]3d^{10}4s^2$ (grupi IIB), dhe e $_{38}Sr$: $[Kr]4d^05s^2$ (grupi IIA).
Pra, zinku dhe stronciumi **NUK** i përkasin të njëjtit grup. **1 pikë**
- c) Halogjenet i përkasin grupit VIIA dhe janë të gjithë jometale. Aktiviteti jometalik zvogëlohet duke zbritur poshtë në grup pasi rritet rrezja atomike. Renditja: $Br < Cl < F$ pasi fluori gjendet në periodën e dytë $2s^2p^5$, klori në të tretën $3s^2p^5$ dhe bromi në të katërtën $4s^2p^5$. **1 pikë**
- a) **1 pikë**
Nëse nxënësi tregon saktë se çfarë përcakton numrin kuantik magnetik m.
- 0 pikë**
Nëse nxënësi e ka përcaktuar në mënyrë të gabuar **OSE** nuk ka shkruar fare në hapësirën e caktuar në dispozicion për zgjidhjen.
- b) **1 pikë**
Nëse nxënësi përcakton saktë se, Zn (Gr. IIB) dhe Sr (Gr. IIA), nuk bëjnë pjesë në të njëjtin grup.
- 0 pikë**
Nëse nxënësi e ka përcaktuar në mënyrë të gabuar **OSE** nuk ka shkruar fare në hapësirën e caktuar në dispozicion për zgjidhjen.
- c) **1 pikë**
Nëse nxënësi shpjegon saktë aktivitetin në rritje të halogjenëve të dhënë.
- 0 pikë**
Nëse nxënësi shpjegon në mënyrë të gabuar **OSE** nuk ka shkruar fare në hapësirën e caktuar në dispozicion për zgjidhjen.

Pyetja 32 **2 pikë****Përgjigje e plotë:**

a) $C_2H_5OH_{(l)} + 3O_{2(g)} = 2CO_{2(g)} + 3H_2O_{(g)}$ $\Delta H_r = -1367 \text{ kJ}$ **1 pikë**

b) $\Delta H_r = (2 \Delta H_f^0 CO_2 + 3 \Delta H_f^0 H_2O_{(g)}) - \Delta H_f^0 C_2H_5OH$

$$\Delta H_f^0 C_2H_5OH = (2 \Delta H_f^0 CO_2 + 3 \Delta H_f^0 H_2O_{(g)}) - \Delta H_r$$

$$\Delta H_f^0 C_2H_5OH = -146 \text{ kJ}$$

1 pikë

2 pikë Nëse nxënësi shkruan saktë barazimin termokimik dhe njehson saktë entalpinë standarde të formimit të etanolit.

1 pikë Nëse nxënësi saktë vetëm barazimin termokimik.

0 pikë Nëse nxënësi e ka zgjidhur në mënyrë të gabuar **OSE** nuk ka shkruar fare në hapësirën e caktuar në dispozicion për zgjidhjen.

Pyetja 33 **4 pikë****Përgjigje e plotë:**

a) Reaksioni i dhënë është redoks sepse kemi ndryshim të numrave të oksidimit, konkretisht: Jodi (I) nga -1 në 0 dhe sqfuri (S) nga +6 në +4 **1 pikë**

b) Në formulën strukturore të acidit metanoik, $\begin{array}{c} \text{H} - \text{C} = \text{O} \\ | \\ \text{OH} \end{array}$, vërehet prania e dy grupeve funksionore, atij karboksilik

dhe aldehidik, gjë që përcakton vetinë e tij për të dhënë edhe këtë reaksion: $HCOOH + Ag^+ \rightarrow CO_2 + Ag + H_2O$ **1 pikë**

c) Alkanoli: propanol-2, $CH_3CH(OH)CH_3$, dhe alkanoni që përftohet prej tij është propanon, CH_3COCH_3 , (Ky është një shembull. Pranohet çdo shembull tjetër) **2 pikë**

a) **1 pikë** Nëse nxënësi përcakton saktë nëpërmjet numrave të oksidimit që reaksioni i dhënë është redoks.

0 pikë Nëse nxënësi jep shpjegim të gabuar **OSE** nuk ka shkruar fare në hapësirën e caktuar në dispozicion për zgjidhjen.

b) **1 pikë** Nëse nxënësi nëpërmjet pranisë së grupit aldehidik brenda strukturës, tregon se acidi metanoik jep edhe reaksionin e kërkuar.

0 pikë Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar **OSE** nuk ka shkruar fare në hapësirën e caktuar në dispozicion për zgjidhjen.

c) **2 pikë** Nëse nxënësi shkruan dhe emërton saktë të dy formulat.

1 pikë Nëse nxënësi shkruan saktë të dy formulat **OSE** shkruan dhe emërton saktë njërin prej tyre.

0 pikë Nëse nxënësi e ka zgjidhur në mënyrë të gabuar **OSE** nuk ka shkruar fare në hapësirën e caktuar në dispozicion për zgjidhjen.

